

# PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT:

## SHËRBIMET E TRANSPORTIT URBAN ME AUTOBUS NË KOMUNËN E PEJËS

### GJENDJA E SEKTORIT TË TRANSPORTIT PUBLIK URBAN NË KOMUNËN E PEJËS

Sistemi i transportit publik në qytetin e Pejës momentalisht nuk ekziston dhe qytetarët që udhëtojnë e që nuk kanë makina të veta aktualisht janë duke shfrytëzuar autotaksitë për udhëtim.

Transporti publik urban është pjesë e domosdoshme e strukturës së shëndetshme socio-ekonomike, urbane dhe dinamike. Qytetarët kanë nevojë të kenë qasje në transport në mënyrë që të shkojnë në punë, në shkollë, për vizitë tek shokët apo familjarët, të kalojnë kohën e lirë apo të bëjnë pazar.

Përkundër vullnetit për zgjidhjen e këtij problemi, kufizimet financiare i kanë imponur Komunës së Pejës që të përfshijë sektorin privat në këtë iniciativë duke u mundësuar qytetarëve mobilitet më të madh në qytetin e Pejës.

### ARSYESHMËRIA E PROJEKTIT

Komuna e Pejës ka nevojë për një shërbim të transportit urban për të përmirësuar transportin në qytet, si dhe për të zvogëluar ngarkesën në trafik dhe ndotjen e ajrit.

Sipas studimit të fizibilitetit të kryer për projektin në fjalë, është dëshmuar se ky projekt është i arsyeshëm në aspektin ekonomik për qytetarët e Pejës si dhe në aspektin financiar.

Komuna nuk ka fonde në dispozicion për të realizuar këtë projekt përmes prokurimit tradicional. Opsioni i një kontrate koncesioni shërbimi, është rekomanduar si opsioni më i mirë për të përmbushur nevojat dhe synimet e këtij projekti.

## PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

• <b>Objektivi i përgjithëm:</b>	Qëllimi i Komunës së Pejës është që sa më shumë të dekurajojë shfrytëzimin e mjetit privat për lëvizje brenda qytetit, duke inkurajuar transportin publik, dhe cilësor.
• <b>Autoriteti kontraktues:</b>	Komuna e Pejës
• <b>Shërbimet e kërkuara:</b>	Komuna e Pejës Komuna ia bartë koncesionarit të drejten ekskluzive si dhe e obligon koncesionarin që gjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe sipas kushteve të kontratës: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kryejë shërbimet e transportit,</li> <li>• Të instalojë dhe të mirëmbajë vendndaljet e autobusëve</li> <li>• Të arkëtojë tarifa për kryerjen e shërbimeve të transportit dhe</li> <li>• Të arkëtojë qira për dhënie në shfrytëzim të pjesëve të vendndaljeve të autobusëve dhe të autobusëve për vendosjen e reklamave në pajtim me këtë kontratë.</li> </ul>
• <b>Struktura e Transaksionit:</b>	Koncesion i shërbimeve
• <b>Kohëzgjatja e pritur e kontratës:</b>	10 vite

## INTERESI I PRITUR I INVESTITORËVE

Sipas Planit Zhvillimor Komunal 2006 – 2025, sektori privat ka shprehur interes për të investuar në zhvillimin e infrastrukturës në Komunën e Pejës duke përfshirë investime në mënyrë financimi, makineri dhe pajisje si dhe me fuqi punëtore.

Në të kaluarën, Komuna e Pejës është përpjekur të kontraktojë një operator privat për shërbime të transportit urban përmes konkursit të hapur. Edhe pse ka pasur interes të madh nga sektori privat për të ofruar këtë lloj shërbimi, kjo nuk ka ndodhur pasi që sektori privat preferonte një kontratë më afatgjatë për kushtet të cilat do të ishte i detyruar t'i plotësoj. Ligji për Partneritet Publiko Privat parasheh mundësinë për të lidhur kontratë afatgjatë me partnerin privat e cila duhet të josh investitorët nga sektori privat.

## STATUSI I PROJEKTIT

Projekti është aprovuar nga ana e Komitetit për Partneritet Publiko Privat në shtator 2011, ndërsa në mars 2012, është përzgjedhur ofertuesi i suksesshëm nga ana e Komunës së Pejës dhe kontrata është aprovuar nga ana e KPPP-së me 17 prill 2012.

## MENAXHIMI I PROJEKTIT

Komuna do të krijojë një Njësi të Menaxhimit të Projektit për të menaxhuar procesin e PPP-së dhe monitoruar performancën pas nënshkrimit të kontratës.